



ETAT DE FRIBOURG
STAAT FREIBURG

Service de l'enseignement spécialisé
et des mesures d'aide SESAM
Amt für Sonderpädagogik SoA

Spitalgasse 3, 1701 Freiburg

T +41 26 305 40 60
www.fr.ch/soa



Çfarë është një VM (verstärkte Massnahme)? (Masa për Ndhimë të Përfocuar)



Për kë është?

Jo të gjithë nxënësit **në shkollë** nuk kanë të njëjtat nevoja.

Disa kanë nevojë për më shumë ndihmë se të tjerët.

Nëse një nxënës ka nevoja të konsiderueshme, ai mund të ketë një VM.

VM është një Masë për Ndhimë të Përfocuar.

Një VM është një formë mbështetjeje për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollë. Nxënësi duhet të ketë një diagnozë mjekësore të fillë si: një tipar lidhur me autizmin, një vonesë intelektuale, etj.

Në përgjithësi, një nxënës merr një VM për 2 vite.
Pas 2 viteve, merret një vendim i ri.

Në kantonin e Fribourg-ut, ka 5 lloje VM:

1. VM edukim i hershëm i specializuar

Ndihma në shtëpi: fëmijët mund të VMrin ndihmë edhe para se të fillojnë shkollën.

Një specialist ofron ndihmë në shtëpi për fëmijët e vegjël nga 0 deri në 6 vjeç.

2. VM integrues

Ndihma në shkollën e fshatit (ose të lagjes): një mësues-mësuse e specializuar ndihmon nxënësin për mësimet e tij në shkollën ku jeton.

Nxënësi integrohet në shkollën e fshatit të tij.

Ndihma ofrohet për **2 deri në 6 orë në javë**.

3. VM Asistent i jetës shkollore

Ndihmë praktike në shkollën e fshatit (ose të lagjes): një ndihmës shkolle ndihmon nxënësin me sigurinë e tij, lëvizjen, veshjen, ngrënien, shkuarjen në tualet, etj.

4. VM Shkolla e specializuar

Ndihma në një shkollë të specializuar: një mësues-mësuse e specializuar ndihmon nxënësin me mësimet e tij **gjatë gjithë ditës së shkollës.**

Një shkollë e specializuar është një shkollë me klasa me pak nxënës.

Në kantonin e Friburgut, ka 9 shkolla të specializuara: Villars-Vert, les Buissonnets, St-Joseph, CEP, Carré d'As-CESL, Clos Fleuri, les Peupliers, CENSG, Flos Carmeli.

5. VM Konvikt shkollor

Nxënësi mund të flenë në shkollën e specializuar.

Hapat e ndryshëm për të VMrë një VM:

1. Dërgimi i kërkesës për VM

Prindërit kërkojnë një VM.

Profesionistët (mësuesit, drejtorja e shkollës, terapistët ose mjekët) ndihmojnë prindërit për te paraqitur kërkesën.

Terapeutët përfshijnë logopedët, psikomotricistët, psikologët, ergoterapistët, etj.

Së bashku me prindërit, ata plotësojnë **formularin e kërkesës për VM.**

Mësuesi-mësusia shkruan një raport pedagogjik.

Ky quhet **përmbledhje pedagogjike**. Përmbledhja pedagogjike shpjegon vështirësitë dhe pikat e forta të nxënësit **në shkollë.**

Një mjek ose terapistët shkruajnë një raport tjetër.

Ky raport shpjegon vështirësitë dhe pikat e forta të nxënësit **në lidhje me diagnozën.**



Si duhet vepruar?




Kur?

Kur duhet të dërgohet kërkesa VM?

Më 31 janar: Profesionistët e shkollës ose prindërit dërgojnë kërkesën VM (së bashku me përmbledhjen pedagogjike) te SoA (Amt für Sonderpädagogik).

Deri më 28 shkurt: Mjekët ose terapistët dërgojnë raportet e tyre te SoA.

Ku duhet të dërgohet kërkesa për VM?



Ku?

Amt für Sonderpädagogik
Spitalgasse 3
1701 Freiburg

2. Vlerësimi paraprak i SoA-it

Një grup personash nga SoA e shqyrton kërkesën.

Ky quhet grupi i vlerësimit.

Grupi i vlerësimit do t'i tregojë inspektorit të specializuar nëse nxënësi është me një aftësi të kufizuar **në shkollë** apo jo. Kjo quhet **vlerësimi paraprak**.

Vlerësimi paraprak dërgohet prindërve me postë.


3. E drejta për t'u dëgjuar

Çfarë ndodh nëse prindërit **nuk** pajtohen me vlerësimin paraprak të grupit ?

Prindërit duan t'i japin informacione inspektorit?

Atëherë ata mund ta bëjnë këtë. Kjo quhet e **drejta për t'u dëgjuar**.

Prindërit kanë **10 ditë për të kontaktuar** inspektorin e specializuar (me telefon, email ose me postë).



Inspektore e specializuar:

Annik Gardaz
Spitalgasse 3
1701 Freiburg



026 305 40 58
annik.gardaz@fr.ch

4. Vendimi i inspektorit të specializuar

Inspektori i specializuar vendos nëse nxënësi do të ketë një VM apo jo. Inspektori i specializuar vendos gjithashtu se cilën VM do t'i jepet nxënësit.

A do të shkojë nxënësi në një shkollë të specializuar?

Inspektori zgjedh shkollën.


5. E drejta e ankimit

Po nëse prindërit **nuk** pajtohen me vendimin?

Atëherë, ata mund ta shprehin këtë. Kjo quhet **ankim**.

Prindërit kanë **10 ditë kohë për ti shkruar** shërbimit juridik të BKAD (Direktion für Bildung und kulturelle Angelegenheiten).

Vendimi u dërgohet prindërve me postë.



BKAD

Juristischer Dienst

Spitalgasse 1

1701 Freiburg



Çdo nxënës me VM ka një **Förderplan** (Projekt Pedagogjik i Individualizuar) Në Förderplan, mësuesi i specializuar shkruan **objektivat e punës së nxënësit**.

Një nxënës me VM mund të punojë objektiva të ndryshme nga nxënësit e tjerë të klasës.

Një nxënës me VM ka dëftesë shkollore të ndryshëm.

Komente të shkruara mund të zëvendësojnë notat.



Për më shumë informacion:

Amt für Sonderpädagogik (SoA)

Spitalgasse 3

1701 Freiburg

T +41 26 305 40 60

www.fr.ch/de/bkad/soa

